



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

Nr. _____ Prot.

Belsh më 02/03/2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik *“Erion Sina”* me Nipt L53303228V, me administrator Z. Erion Sina.

Adresa: Lagja nr 3, Rr, Cërrik – Paper, me nr pasurie 7169, zona kadastrale 2441, Cërrik, Elbasan.

* * *

Procedura e prokurimit: Shërbim, (Kërkesë për propozim)

Numri i referencës së procedurës: REF-84709-01-25-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *“Mirmbajtja e mjeteve te shërbimit te Bashkise Belsh”.*

Fondi limit: 2 480 000 (Dy milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSh, me burim financimi Buxheti i Bashkisë Belsh , miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga lidhja e kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [11.11.2019] [45]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në procedurë një ofertues me vlerë përkatëse të ofruara.

1. Operatori Ekonomik *“Erion Sina” sh.p.k*

L53303228V

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

1 423 390(një milion e katërqind e njëzet e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH.
(me numra dhe fjalë)

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik *“Paola” shpk* me Nipt: K63113202D me adresë Belsh Elbasan MARINES, me administrator Z. Apostol Paja, është paraqitur me ofertë ekonomike me **1 251 150** (një milion dyqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Operatori ekonomik *“Paola” shpk* nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë ligjor për të dëshmuar plotësimin e kërkesave për kualifikim të kërkuara sipas DST.

Konkretisht:

1.1 Operatori nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë e të saktë për plotësimin e **pikës**

2.3 ku operatori duhet të përmbushi kapacitetin teknik.

Konkretisht në pikën 2.3/a kërkohet që “operatori ekonomik duhet të provojë përvojën e mëparshme , duke paraqitur dëshmi për shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% të fondit limit pa Tvsh, të realizuar (nga ju) në tri vitet e fundit financiar nga dita e zhvillimit të tenderit.

Për këtë rast të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe në rastin e përvojave të mëparshme të realizuara me sektorin privat vetëm fatura tatimore të shitjes ku të dallohen saktë të dhënat. Plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

Nisur sa më sipër nga verifikimi i dokumentave të vendosura në sistemin elektronik për këtë kriter ju keni vendosur **vetëm fatura tatimore shitje** te realizuara me Bashkinë Belsh, Qendrën Shëndetësore Belsh, Ujësjellës Kanalizime Belsh dhe me subjekte privat.

1.1.1 Në DST është e cilësuar se në rastin e përvojave të realizuara me entet publike duhet të paraqitni **vërtetimin e realizimit me sukses nga Autoriteti Kontraktor**, ndersa ju keni paraqitur vetëm fatura tatimore shitje (për shërbimet e realizuara me Bashkinë Belsh), pra mungon vërtetimi i realizimit nga anan e AK, që sjell mosplotësimin e këtij kriteri.

1.1.2 Ne lidhje me faturat tatimore të shitjes te realizura me sektorin privat, këto fatura **nuk përmbushin vlerën 40% të fondit limit (2 480 000 lekë pa tvsh)** të prokuruar nga autoriteti kontraktor i vendosur në DST.

Pra është kërkuar që për kualifikimin e operatorit të paraqitet pika e sipërpërmendur, ndërkohë që operatori nuk e ka paraqitur siç është kërkuar këtë pikë sepse faturat tatimore të shitjes nuk përputhen me vlerën e 40% të fondit limit të procedurës së prokurimit nga autoriteti kontraktor.

Përderisa operatori nuk ka dërguar kërkesë për sqarim dhe as ankesë për këto kritere atëherë ka qënë i detyruar të paraqesë këto kritere specifikisht sic janë kërkuar në DST.

Mosparaqitja e tyre në mënyrë të saktë përbën kusht për skualifikim.

Në nenin 53/3 të LPP-së parashikohet se “Autoriteti kontraktor ,në zbatim të pikës 4 të këtij neni ,vlerëson një ofertë si të vlefshme ,vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet teknike e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe me dokumentat e tenderit”.

Persa më sipër KVO vendos të vlerësojë si të pavlefshme ofertën e operatorit “Paola” shpk.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [Operatorin Ekonomik “**Erion Sina**” **sh.p.k.** me Nipt: L53303228V, vendi i ushtrimit të profesionit Lagja nr 3, Rr, Cërrik – Paper, me nr pasurie 7169, zona kadastrale 2441, Cërrik, Elbasan. me administrator Z. Erion Sina, i cili nuk është prezent në ambientet ku po hapen ofertat është paraqitur oferta ekonomike me **1 423 390(një milion e katërqind e njëzet e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë)** Lekë pa TVSH pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkisë Belsh, Njësisë së Prokurimit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10/ 02/ 2021

Ankesa: Po

Operatori ekonomik “Paola” shpk me Nipt: K63113202D me adresë Belsh Elbasan MARINES, me administrator Z. Apostol Paja, ka bere ankesë me date 12.02.2021 nr. 545 prot dhe ka marr përgjigje me date 17.02.2021 me nr. 545/1 prot.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
K R Y E T A R I
Arif TAFANI